



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 124/2 Prot.

Gramsh, më 21.02. 2024

VENDIM

Nr. 3 Datë 26 /01/2024

Për

Miratimin e kontratës së *“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Gramsh”* në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë”, bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

VENDOSI

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së *“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Elbasan”*, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., sipas draftit bashkangjitur.
2. Efektet financiare të zbatimit të kësaj marrëveshje mbulohen nga buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2024 me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.88 datë 27.12.2023.
3. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Enis ZANI

